

S T A T U T I

I

SHOQËRISË “NOVARA” SHPK

Sot, më datë 12.06.2023 (dymijë e njëzet e tre), themelohet shoqëria “NOVARA” SHPK në praninë e Ortakëve Themelues të saj si më poshtë:

1. **Z. Loran Shkurta** i biri i Sazan shtetas shqiptar i datëlindjes 19.02.1984, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë me adresë Rruga “S. Bruzi nr. 1 – Laprake, Tiranë, identifikuar me letërnjoftimin me numer 038762040 dhe numër personal I40219067E, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar.
2. **Z. Iglil Osja**, i biri i Ahmet shtetas shqiptar i datëlindjes 04.07.1983, lindur në Shkodër banues në Tiranë me adresë Rruga “ Ali Visha”, Njësia Bashkiake nr. 2 P. 70, ap. 4 , identifikuar me letërnjoftimin me nr. 035171165 dhe numër personal I30704030V, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar.
3. **Z. Osjon Osja**, i biri i Ahmet shtetas shqiptar i datëlindjes 24.11.1986, lindur në Shkodër banues në Tiranë me adresë Rruga “ Ali Visha”, Njësia Bashkiake nr. 2 P. 70, ap. 4 , identifikuar me letërnjoftimin me nr. 037543608 dhe numër personal I61124080L, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar.
4. **Z. Ermal Dragusha** i biri i Ahmet shtetas shqiptar i datëlindjes 26.03.1987, lindur në Shkodër banues në Shkodër me adresë Lagjja Daniel Matli, Shkodër, identifikuar me letërnjoftimin me nr. 038547757 dhe numër personal I70326107J, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar.

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me Aktin e Themelimit, legjislacionin tregtar në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe me parashikimet e këtij Statuti.

I. DISPOZITA TË PËRGGJITHSHME

NENI 1

Emri, selia dhe vula e Shoqërisë

- 1.1. Shoqëria “NOVARA” SHPK është person juridik privat, i themeluar dhe organizuar sipas së drejtës së Republikës së Shqipërisë.
- 1.2. Shoqëria emërtohet dhe do të ushtrojë aktivitetin e saj nën emrin “NOVARA”.
- 1.3. Selia e Shoqërisë ndodhet në Tiranë, Shqipëri, në adresën: Rruga "Ali Visha" Njësia Bashkiake nr. 2, Nd.70, Ap. 4/1, Tiranë, Shqipëri.

- 1.4. Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë selinë e saj në një adresë dhe/ose qytet tjetër brenda Republikës së Shqipërisë, si dhe ka të drejtë të hapë degë ose zyra përfaqësimi të saj kudo brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

NENI 2

Objekti i veprimtarisë

Objekti i Veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë, por duke mos u kufizuar në të:

Në fushën e turizmit, hotelerisë, shitje / blerje biletash avioni, trageti, autobusi dhe/apo te mjeteve te ndryshme te organizimit e formave te udhetimeve turistike, udhetime pune etj. Shitje / blerje te paketave turistike, evenimenteve zyrtare dhe jo-zyrtare, organizim konferencash, seminaresh. Udhetime Turistike me grupe te organizuara brenda dhe jashte vendit. Shitje / blerje biletash per evente sportive dhe evenimente te ndryshme kulturore dhe artistike. Makina me qera. siguracion shendeti ne udhetim. Organizim turesh brenda dhe jashte vendit. Pushime dhe udhetime me kroçiera. Shoqeria bashkepunon me agjenci te tjera turistike, udhetimi, shoqeri transportesh etj, vendase dhe / apo te huaja, hotele, resorte, restorante, individe, familje etj, qe kane objekt veprimtarie te njejte me te apo qe lidhen me objektin e saj te veprimtarise. Shoqeria do te kryeje aktivitet ne fushen e promovimit te turizmit vendas e te huaj, bashkepunim me agjenci, persona juridike, fizike, individe, institucione te ndryshme shteterore / publike / private, etj; Shoqeria organizon ture te ndryshme te permasave te ndryshme ne pjesemarrje, objektiv udhetimi, qellime udhetimi. etj, te ndryshme, brenda dhe jashte vendit, ne perputhje me legjislacionin e RSH dhe ate nderkombetar. Shitje te produkteve te agjensise (bileta avioni, bileta autobusi, makina me qera, transferta, eskursionet, rezervime apartamentesh dhe hotelesh, udhetime turistike, bileta eventesh koncerte, sport, etj) Bed & breakfast, Bar & restorant. Tregti me shumice dhe me pakice. Import, export dhe tregtim i mallrave te konsumit dhe industriale. Konsulence import-export, konsulence marketingu, konsulence financiare. Aktivitete sportive dhe rekreative

2.1. NENI 3

Kohëzgjatja e Shoqërisë

- 3.1. Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit është i pakufizuar dhe ka filluar me regjistrimin e shoqërisë në regjistrin tregtar.

NENI 4

Forma e Shoqërisë

- 4.1. Shoqëria organizohet në formën e “shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (SHPK)” dhe gëzon personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj.
- 4.2. Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të Aktit së Themelimit, Statutit, si dhe dispozitave të legjislacionit tregtar e atij civil në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

- 4.3. Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, Shoqëria mund të vendosë shndërrimin e saj në përputhje me nenet 228 e vijues të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar) (më tej referuar si “*LTSH*”).

II. TË DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKËVE

NENI 5

Ortakët e Shoqërisë

- 5.1. Shoqëria ka 4 (kater) ortakë, përkatësisht:
- 5.1.1. Z. Loran Shkurta, i cili zotëron 1 (një) kuotë, që jep të drejtën e pjesëmarrjes me 40% në kapitalin bazë të Shoqërisë;
 - 5.1.2. Z. Osjon Osja, zotëron 1 (një) kuotë, që jep të drejtën e pjesëmarrjes me 40% në kapitalin bazë të Shoqërisë,
 - 5.1.3. Z. Iglil Osja, i cili zotëron 1 (një) kuotë, që jep të drejtën e pjesëmarrjes me 15% në kapitalin bazë të Shoqërisë
 - 5.1.4. Z. Ermal Dragusha, , i cili zotëron 1 (një) kuotë, që jep të drejtën e pjesëmarrjes me 5% në kapitalin bazë të Shoqërisë
- 5.2. Ortakët e shoqërisë kanë të drejtë të tjetërsojë pronësinë mbi kuotën – tërësisht apo pjesërisht, si dhe të kalojnë tërësisht apo pjesërisht të drejtat e lidhura me kuotën dhe kapitalin e zotëruar tek persona të tretë, por pasi t’ua kenë ofruar për blerje ortakëve brenda shoqërisë me kushte jo më pak të favorshme nga ato që do iu ofrohen të tretëve. Oferta u komunikohet me shkrim ortakëve, të cilët kanë të drejtën e parablerjes, të drejtë të cilën duhet ta ushtrojnë me njoftim me shkrim brenda 30 ditëve nga data e komunikimit, në të kundërt oferta konsiderohet e refuzuar prej ortakëve që gëzojnë këtë të drejtë. Transferimi i kuotës tek të tretët sipas këtij paragrafi, si dhe në rastin e tjetërsimit të kuotës/kuotave nëpërmjet dhurimit, në çdo rast do të kryhet pas dhënies së miratimit nga asambleja e ortakëve.

NENI 6

Përgjegjësia e ortakëve

- 6.1. Ortakët themelues të shoqërisë mbajnë përgjegjësi për humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara.
- 6.2. Pasuritë e krijuara nga shoqëria gjatë aktivitetit të saj janë në pronësi të ortakëve të Shoqërisë. Ato mund të tjetërsohen, të jepen me qira, të lihen peng e hipotekë dhe të lihen me trashëgimi me anë të vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të shoqërisë.

NENI 7

Të drejtat dhe detyrimet e Ortakëve

- 7.1. Ortakët e shoqërisë japin kontributin e tyre në shoqëri në para apo në natyrë, sipas mënyrave dhe afateve të përcaktuara në statut. Ata përgjigjen ndaj shoqërisë personalisht për dëmet e shkaktuara nga mospërbushja e këtyre detyrimeve apo nga përmbushja e tyre përtej afateve përkatëse.
- 7.2. Personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë informojnë ortakët për ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare dhe me kërkesën e tyre, duhet t'i vënë në dispozicion llogaritë vjetore, përfshirë llogaritë e konsoliduara, raportet për gjendjen dhe ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare, raportet e organeve drejtuese apo të ekspertëve kontabël të autorizuar, si dhe çdo dokument tjetër të brendshëm të shoqërisë, me përjashtim të rastit të sekretit tregtar, i cili është një e dhënë e vlerësuar nga shoqëria si informacion i brendshëm apo dokument që shoqëria mbron, që në rast se do t'iu përhapëj personave të paautorizuar do t'i shkaktonte dëm të konsiderueshëm interesave tregtare të shoqërisë.
- 7.3. Ortakët e shoqërisë kanë të drejtë të heqin dorë nga shoqëria dhe të shesin pjesën e tyre të kapitalit, në përputhje me kushtet e përcaktuara në Statut dhe nga LTSHT. Heqja dorë nga shoqëria nuk i liron ata nga detyrimet që kanë ndaj shoqërisë deri në momentin e heqjes dorë dhe nuk rrezikon marrjen e të ardhurave nga shoqëria të siguruara deri në atë moment.
- 7.4. Gjatë ushtrimit të të drejtave, ortakët veprojnë duke marrë parasysh interesat e shoqërisë. Ortakët respektojnë detyrimet që burojnë nga Statuti.

III. KAPITALI I SHOQËRISË

NENI 8

Kapitali Bazë

- 8.1. Kapitali bazë i shoqërisë është në vlerën ALL 1,000 (një mijë lekë), i përbërë nga 4 (katër) kuota, ku kuota e zotëruar nga ortaku Z. Loran Shkurta i jep të drejtën e pjesëmarrjes me 40% (dyzetë përqind) në kapitalin bazë, të drejtat dhe detyrimet e shoqërisë; kuota e zotëruar nga ortaku Z. Osjon Osja i jep të drejtën e pjesëmarrjes me 40% (dyzetë përqind) në kapitalin bazë, të drejtat dhe detyrimet e shoqërisë; kuota e zotëruar nga ortaku Z. Iglil Osja i jep të drejtën e pjesëmarrjes me 15% (pesëmbëdhjetë përqind) në kapitalin bazë, të drejtat dhe detyrimet e shoqërisë; kuota e zotëruar nga ortaku Z. Ermal Dragusha i jep të drejtën e pjesëmarrjes me 5% (pesë përqind) në kapitalin bazë, të drejtat dhe detyrimet e shoqërisë.
- 8.2. Kuota e ortakut Z. Loran Shkurta ka vlerë nominale ALL 400 (katër qind lekë), kuota e ortakut Z. Osjon Osja ka vlerë nominale ALL 400 (katërqind lekë); kuota e ortakut Iglil Osja ka vlerë nominale ALL 150 (njëqind e pesëdhjetë lekë), kuota e ortakut Z. Ermal Dragusha ka vlerë nominale ALL 50 (pesëdhjetë lekë).
- 8.3. Kapitali bazë është nënshkruar dhe paguar në tërësinë e tij nga ortakët themelues.

NENI 9

Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave

- 9.1. Kuotat e kapitalit bazë të Shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre fitohen ose kalohen vetëm nëpërmjet:
- 9.1.1. kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - 9.1.2. shitblerjes;
 - 9.1.3. trashëgimisë;
 - 9.1.4. dhurimit;
 - 9.1.5. në çdo mënyrë tjetër të parashikuar në ligj.
- 9.2. Në rastet kur kjo gjen zbatim, Ortakët e Shoqërisë gëzojnë të drejtën e parablerjes ndaj njëri-tjetrit. Përkatësisht, asnjë ndër ortakët nuk ka të drejtë ta shesë kuotën e tij tërësisht apo pjesërisht në favor të një të treti, apo të kalojë pjesërisht apo tërësisht të drejtat e lidhura me të, pa ia ofruar paraprakisht me të njëjtat kushte ortakut tjetër. Ortaku që dëshiron të shesë kuotën/pjesën e kapitalit që zotëron në Shoqëri njofton ortakët e tjerë me shkrim nëpërmjet “Njoftimit për shitje” duke u dhënë atyre 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga data e marrjes së këtij njoftimi për të negociuar në lidhje me shitjen e kuotës/pjesës së kapitalit. Njoftimi për shitje duhet të përmbajë:
- 9.2.1 Përqindjen e pjesës së kapitalit që ortaku do të shesë;
 - 9.2.2 Çmimin e shitjes dhe kushtet e pagesës.
- 9.3. Në rast se në përfundim të afatit 30 ditor, ortakët nuk pranojnë të blejnë kuotën/pjesën e kapitalit të ortakut shitës ose heshtin, atëherë ortaku shitës ka të drejtë që të shesë kuotën/pjesën e kapitalit që ai zotëron në shoqëri tek të tretë me kushte jo më pak të favorshme se ato të ofruara ortakëve të shoqërisë.
- 9.4. Shitblerja e kuotës e kryer në kundërshtim me këtë nen do të jetë absolutisht i pavlefshëm.

IV. KUSHTET EKONOMIKE DHE FINANCIARE TË SHOQËRISË

NENI 10

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

- 10.1. Kapitali bazë mund të zmadhohet ose të zvogëlohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë.
- 10.2. Zmadhimi i kapitalit mund të vendoset kur e kërkojnë interesat e Shoqërisë, duke e reflektuar ndryshimin në kapital në vlerën nominale të kuotës së secilit ortak, në vlerë të barabartë me kontributin individual të tij.
- 10.3. Zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë nuk duhet të dëmtojë kreditorët e as të krijojë pasiguri tek ata që kanë dhënë kredi përpara publikimit të zvogëlimit të kapitalit.

NENI 11

Fondet rezervë

- 11.1. Shoqëria krijon rezervën ligjore, e cila duhet të jenë e barabartë me 10% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë, si dhe fonde të tjera financimi për të përballuar nevojat e saj ekonomike.
- 11.2. Ajo disponon lirisht mjetet e saj financiare për shlyerjen e detyrimeve gjatë veprimtarisë së saj.

NENI 12

Përdorimi i të ardhurave neto

- 12.1. Të ardhurat neto që rezultojnë pasi zbriten shpenzimet e bëra për kryerjen e çdo lloj aktiviteti, përfshirë zbritjen e vlerës së amortizimit, tatimet dhe taksat, kuotat që rritin kredinë për investime, pagat e shpërblimet, përdoren nga Ortakët, sipas qëllimeve të tyre.

NENI 13

Bilanci

- 13.1. Pasuria e Shoqërisë vlerësohet në bilancet e saj në monedhë të vendit ose në monedhë të huaj.
- 13.2. Bilanci vjetor paraqitet brenda datës 31 Mars të çdo viti për vitin paraardhës financiar.
- 13.3. Forma e bilancit përcaktohet nga Administratori në harmoni me format e bilanceve të vendosura në Republikën e Shqipërisë.

NENI 14

Plani financiar

- 14.1. Plani financiar parashikon aktivin e pasivin e aktivitetit ekonomik të Shoqërisë, të shprehur në lekë ose valutë të konvertueshme. Llogaria ekonomike do të mbahet në Shqipëri.
- 14.2. Shkëmbimi i monedhës shqiptare me atë të huaj dhe anasjelltas bëhet sipas kursit zyrtar ose privat të këmbimit.

NENI 15

Shpërndarja e fitimeve

- 15.1. Ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimeve vjetore (dividentin) të deklaruara në pasqyrat financiare të shoqërisë.
- 15.2. Me vendim unanim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, shpërndarja e dividendit mund të kryhet në mënyrë jo-proporcionale me përqindjen e pjesëmarrjes së ortakëve në kapitalin bazë të shoqërisë.

NENI 16

Kufizimi i shpërndarjeve të fitimeve

- 16.1. Shoqëria do të shpërndajë fitimet e ortakëve në fund të çdo viti financiar, pas miratimit të bilancit nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:
 - 16.1.1. aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;

- 16.1.2. shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.
- 16.2. Administratorët lëshojnë një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e mësipërme.
- 16.3. Kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush këto kritere, administratorët nuk mund ta lëshojnë këtë certifikatë.
- 16.4. Administratorët përgjigjen ndaj shoqërisë për vërtetësinë e certifikatës së aftësisë paguese.
- 16.5. Administratorët, të cilët nga pakujdesia lëshojnë një certifikatë të pasaktë të aftësisë paguese, përgjigjen personalisht përpara shoqërisë për kthimin e dividendëve të shpërndarë.
- 16.6. Ortakët, që kanë marrë nga shoqëria dividendë, përgjigjen personalisht ndaj shoqërisë për kthimin e dividendëve, që u janë shpërndarë kur nuk është lëshuar certifikata e aftësisë paguese, ose kur pavarësisht lëshimit të certifikatës, këta ortakë kanë pasur dijeni për gjendjen e paaftësisë paguese, ose në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishin pasur dijeni për këtë gjendje.

V. ORGANET E SHOQËRISË

NENI 17

Asambleja e Përgjithshme

- 17.1. Organi themelor i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, e cila kur shoqëria ka një ortak të vetëm përbëhet nga ky i fundit.
- 17.2. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve merr vendime për:
- 17.2.1. përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - 17.2.2. ndryshimet e statutit;
 - 17.2.3. emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - 17.2.4. emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - 17.2.5. përcaktimin e shpërblimeve për administratorët, likuiduesit dhe ekspertët kontabël të autorizuar.
 - 17.2.6. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - 17.2.7. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - 17.2.8. zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - 17.2.9. pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - 17.2.10. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - 17.2.11. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - 17.2.12. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - 17.2.13. çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

NENI 18

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

- 18.1. Asambleja e Përgjithshme mbledhet sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë.
- 18.2. Mbledhja e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët të cilët përfaqësojnë të paktën 5% të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë.
- 18.3. Asambleja e përgjithshme thirret detyrimisht nëse:
 - 18.3.1. sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
 - 18.3.2. shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
 - 18.3.3. shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

NENI 19

Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

- 19.1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftim nëpërmjet postës elektronike.
- 19.2. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- 19.3. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur si më sipër, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

NENI 20

Kuorumi i nevojshëm dhe vendimmarrja

- 20.1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kapitalit bazë të shoqërisë.
- 20.2. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të cilësuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se

gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike.

- 20.3. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më sipër, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.
- 20.4. Asambleja e përgjithshme vendos me $\frac{3}{4}$ (tre të katërtat) e votave të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 20.5. Për çështjet e tjera, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.
- 20.6. Çdo ortak ka të drejta vote në përpjesëtim me vlerën nominale të kuotës së tij.
- 20.7. Ortakët, që nuk janë të pranishëm, kanë mundësinë e pjesëmarrjes në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve.
- 20.8. Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cënimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cënimit të këtyre të drejtave.

NENI 21

Procesverbali i mbledhjes së asamblesë

- 21.1. Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal.
- 21.2. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme.
- 21.3. Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit.
- 21.4. Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.
- 21.5. Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

VI. ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

NENI 22

Rregullat për emërimin dhe shkarkimin e Administratorëve dhe kompetencat e tyre

- 22.1. Asambleja e përgjithshme emëron deri në tre persona fizikë (individë) si administratorë të shoqërisë.
- 22.2. Afati i emërimit, nuk mund të jetë me i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje.
- 22.3. Kompetencat, të drejtat dhe detyrimet e Administratorit do të përcaktohen në aktin e emërimit të tij nga Asambleja e Përgjithshme.
- 22.4. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

22.5. Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

NENI 23

Administratorët aktualë të Shoqërisë

23.1. Administrator i Shoqërisë “NOVARA” SHPK, do të jetë:

23.1.1. **Z.Igli Osja**, shtetas shqiptar, lindur në Shkodër, më 04.07.1983 dhe banues në Tiranë, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit me nr.personal I30704030V, i cili emërohet për një afat 5 (pesë) vjeçar, me të drejtë riemërimi.

23.2. Administratori i sipërcituar emërohet për një afat 5 (pesë) vjeçar me të drejtë riemërimi, duke nisur ky afat nga data e regjistrimit të tij pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

23.3. Shoqëria do të përfaqësohet përpara çdo organi administrativ, gjyqësor, apo çdo entiteti tjetër publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori i shoqërisë, i cili i ushtron të drejtat e tij në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi, apo nga një ose disa persona të autorizuar prej tij.

NENI 24

Të drejtat dhe detyrimet e administratorëve

24.1. Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

24.1.1. Kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

24.1.2. Përfaqësojë shoqërinë tregtare;

24.1.3. Kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

24.1.4. Përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

24.1.5. Krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

24.1.6. Kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;

24.1.7. Kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

NENI 25

Shpërblimi i administratorëve

- 25.1. Shpërblimit bazë të administratorit mund t'i bëhen shtesa, që mund të jenë përqindje në fitim ose të ngjashme. Shpërblimet e administratorit përcaktohen me vendim të zakonshëm të Asamblesë së Përgjithshme.
- 25.2. Shpërblimi, duhet të jetë i përshtatshëm dhe në përputhje me detyrat e administratorit dhe gjendjen financiare të shoqërisë.
- 25.3. Nëse shoqëria është në vështirësi financiare, asambleja e përgjithshme mund të vendosë reduktimin e shpërblimit të administratorit në masën e përshtatshme.
- 25.4. Kriteret e shpërblimit, shpërblimi individual dhe efekti vjetor i shpërblimit të administratorit në strukturën e kostove të shoqërisë tregtare publikohen së bashku me pasqyrat financiare vjetore.

NENI 26

Ekspertët Kontabël

- 26.1. Shoqëria cakton ekspert(ë) kontabël për çdo vit financiar në rastet e përcaktuara në ligj. Emërimin e tyre e bën Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.
- 26.2. Ekspertët kontabël mbajnë përgjegjësi për mbajtjen e rregullt të të gjithë dokumentacionit të Shoqërisë.
- 26.3. Ata përgjigjen për dëmet që i vijnë Shoqërisë nga mbajtja e parregullt e llogarive ose verifikimi i tyre i gabuar.
- 26.4. Nuk mund të ngarkohen me detyrën e ekspertit, themeluesi, administratori, si dhe personat që janë gjini e krushqi me ata deri në shkallën e katërt.

VII. MARRËDHËNIET E PUNËS

NENI 27

Marrëdhëniet e punës

- 27.1. Marrëdhëniet e punës në Shoqëri rregullohen sipas dispozitave të Aktit të Themelimit, Statutit dhe Legjislacionit Shqiptar të Punës.
- 27.2. Punësimi në Shoqëri realizohet me anë të kontratave individuale ose kolektive të punës midis Shoqërisë e punëmarrësve.
- 27.3. Bën përjashtim nga parashikimet e këtij neni marrëdhënia mes shoqërisë dhe administratorit(ëve) të saj, e cila rregullohet sipas ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar).

NENI 28

Përgjegjësitë e punëmarrësve

28.1. Punëmarrësit dhe punonjësit drejtues administrativë janë përgjegjës për dëmet që i shkaktojnë me faj Shoqërisë dhe/ose të tretëve në marrëdhënie kontraktore apo administrative me shoqërinë dhe përgjigjen përpara saj civilisht.

VIII. PRISHJA E SHOQËRISË. LIKUIDIMI

NENI 29

Prishja e shoqërisë

29.1. Kjo Shoqëri do të prishet në rastet kur:

29.1.1. Prishja vendoset nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë.

29.1.2. Me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;

29.1.3. Në rast se objekti bëhet i porealizueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;

29.1.4. Në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 i LTSHT, kur pavlefshmëria është konstatuar me vendim gjyqësor të formës së prerë;

29.1.5. Me vendim gjyqësor të formës së prerë;

29.1.6. Në raste të tjera, të parashikuara me ligj.

29.2. Prishja e shoqërisë regjistrohet në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit nga Administratorët.

NENI 30

Likuidimi i shoqërisë

30.1. Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga asambleja e përgjithshme. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

30.2. Çdo person i interesuar, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës zëvendësimin e likuiduesit, sipas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, nëse paraqet arsye të mjaftueshme për të dyshuar se likuidimi i rregullt i shoqërisë mund të cenohet nga likuiduesit e emëruar si më sipër. Kërkesa duhet të depozitohet në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e caktimit të likuiduesit.

- 30.3. Gjykata emëron likuiduesin, në rastet kur shoqëria tregtare prishet me vendim gjykate. Likuiduesit shkarkohen dhe zëvendësohen me të njëjtat kushte, të parashikuara në dispozitat për emërimin e tyre.
- 30.4. Administratorët e shoqërisë i njoftojnë për regjistrim, Qendrës Kombëtare të Biznesit të dhënat e likuiduesve të parë dhe tagrat e tyre, për të përfaqësuar shoqërinë, së bashku me dokumentet përkatëse. Likuiduesit depozitojnë nënshkrimin e tyre.
- 30.5. Likuiduesit i njoftojnë, gjithashtu, Qendrës Kombëtare të Biznesit për regjistrim çdo ndryshim për identitetin dhe tagrat e tyre të përfaqësimit.
- 30.6. Likuiduesit duhet të ftojnë kreditorët e shoqërisë për të depozituar pretendimet e tyre për prishjen e saj. Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.

NENI 31

Të drejtat dhe detyrimet e likuiduesit

- 31.1. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.
- 31.2. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

NENI 32

Bilancet

- 32.1. Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.

NENI 33

Shpërndarja e aktiveve

- 33.1. Pas shlyerjes së detyrimeve ndaj kreditorëve, likuiduesi i shpërndan ortakëve të shoqërisë aktivet e mbetura, sipas të drejtave që ata kanë në ndarjen e fitimeve.
- 33.2. Pasuritë, që i janë dhënë shoqërisë me qira apo në përdorim, me çfarëdo titulli i kthehen ortakut që i ka dhënë ato.
- 33.3. Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Biznesit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë.

IX. DISPOZITA TË FUNDIT

NENI 34

Hyrja në fuqi

34.1. Ky Statut hyn në fuqi pas regjistrimit të tij pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

NENI 35

Dispozita kalimtare

- 35.1. Çdo çështje e cila nuk është parashikuar shprehimisht në këtë Statut do të rregullohet nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë, e veçanërisht nga ligji nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar).
- 35.2. Ky Statut hartohet në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe, nga një për secilin ortak, një për tu arkivuar nga Shoqëria dhe një për t’u depozituar e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe nënshkruhet pa vërejtje nga Ortakët e Shoqërisë.

ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË “NOVARA” SHPK

Loran Shkurta

Osjon Osja

Iglil Osja

Ermal Dragusha

